

Sigurimi i jetes per hua Permbledhje e Kushteve e Përgjithshme të Sigurimit

Kontrata e Sigurimit i jetes per hua ofrohet per personat huamarres. Kjo kontrate garanton shlyerjen e shumës te pakthyer të huasë në momentin e humbjes së jetës te humarresit sipas parashikimeve te Polices. Në përputhje me përcaktimin në formularin e policës së sigurimit dhe parashikimet e Kushteve të Përgjithshme të sigurimit, pervec mbulimit te humbjes te jetes mund te ofrohen edhe:

- 'Paaftesi e plote e perhershme nga Aksidentet'
- 'Paaftesi e pjesshme e perhershme nga Aksidentet'
- 'Sigurim I pjesshem I Shpenzimeve Spitalore nga Aksidentet'

Ne zbatim te ligjit Nr 52, date 22.05.2014 "per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit paraqesin si vijon permbjedhjen e kushteve te Sigurimit te jetes per hua.

Përkufizime

'SIGAL Life': shoqëria e sigurimeve SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA Sh.A., Blv. Zog I, Nr.1 Qendra e Biznesit SIGAL, Njesia Bashkiake Nr 9, Tiranë, e autorizuar nga Komisioni i Mbikqyrjes së Sigurimeve për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit për Jetën.

'Policëmbajtësi': emërtohet në formularin e policës së sigurimit. Vetëm policëmbajtësi ka të drejtën të marrë të gjitha përfitimet dhe të ushtrorë të gjitha të drejtat që jep kjo policë ose që miraton SIGAL Life.

'Përfituesi': emërtohet në formularin e policës së sigurimit. SIGAL Life do t'i paguajë përfituesit përfitimin e pagueshëm, në përputhje me kushtet e kësaj police.

'I siguruari': individi i përcaktuar si i tillë në formularin e policës së sigurimit, jeta e të cilit sigurohet sipas kësaj police. I Siguruari mund të jetë individi kredimarrës i Policëmbajtësit ose administratori/pronari i subjektit kredimarrës.

'Ngjarje sigurimi': ngjarje e ardhshme, e paparashikueshme, jo e sigurtë, që është e pavarur nga vullneti i të siguararit, që sjell si rrjedhojë të drejtën e policëmbajtësit/përfituesit për të kërkuar përfitimin e pagueshëm.

'Viti i sigurimit': fillon në datën e përcaktuar në Formular si datë 'Fillimi i vitit të sigurimit' dhe përfundon në datën e përcaktuar në Formular si datë 'Përfundimi i vitit të sigurimit' për vitin përkatës të sigurimit.

'Shuma e sigurimit': do të jetë shuma e përcaktuar si e tillë në formularin e policës së sigurimit.

Në rastet kur dy ose më shumë individë janë siguar për të njëjtën kredi, shuma e sigurimit ndahet në përpjestim të drejtë ndërmjet këtyre individëve, përveçse kur parashikohet ndryshe në formularin e policës. I njëjti parim përpjestimor zbatohet për ndarjen e shumës së mbetur të kredisë dhe përfitimin e pagueshëm.

'Shuma e mbetur e kredisë': do te jetë shuma e mbetur e principalit të borxhit të kredimarrësit ndaj bankës për kredinë për të cilën është siguar, në datën e caktuar, në përputhje me tabelën e amortizimit të kredisë (duke përjashtuar interesat e kredisë, pagesat e vonuara, interesat për pagesat e vonuara dhe çdo komision/shpenzim tjetër bankar).

Shuma e mbetur e kredisë në asnjë rast nuk mund të jetë më e madhe se shuma e sigurimit të vitit përkatës të sigurimit.

'Këst mujor': Shumë e njëjtë periodike (mujore) që kredimarrësi i paguan Policëmbajtësit për shlyerjen e kredisë në përputhje me tabelën e kthimit të kredisë (tabela e amortizimit të kredisë), që përfshin principalin dhe interesin. Tabela e kthimit të kredisë i bashkëngjitet dokumentacionit të sigurimit dhe është pjesë e tij.

'Monedha': monedha e kredisë.

'Aksident': Një ngjarje e menjëhershme, e papritur dhe e paparashikuar që ndodh pa vullnetin e të siguararit, e identifikueshme për sa i përket kohës dhe vendit të ndodhjes, që ka impakt trupor të drejtpërdrejtë, të jashtëm dhe të dhunshëm mbi të siguararin.

'Humbja Aksidentale e Jetës': Humbja e jetës të të siguararit si rrjedhojë e një aksidenti që ndodh brenda periudhës të sigurimit, humbje jete që ndodh brenda 12 muajsh nga data e këtij aksidenti.

'Humbja e Jetës': Humbja e jetës së të siguararit brenda periudhës të sigurimit.

Sigurimi i 'Paaftësisë së Plotë të Përhershme nga Aksidentet' - ngjarja e sigurimit do të jetë 'Humbja e aftësisë për punë e të Siguararit që e ndalon plotësisht të siguararin për t'u marrë me çdo veprimtari ekonomike ose punë të çdo lloji dhe që zgjat dymbëdhjetë muaj dhe në fund të kësaj periudhe është pa shpresë për mirësimi, shkaktuar nga një Aksident që ndodh brenda periudhës së sigurimit',

Sigurimi i 'Paaftësisë së Pjesshme të Përherhshme nga Aksidentet' - ngjarja e sigurimit do të jetë 'Humbja e pjesshme e aftësisë për punë e të Siguarit me pasojë humbjen anatomike ose humbjen e përherhshme funksionale të një ose disa organeve ose gjymtyrëve të të Siguarit, sipas përcaktimeve të 'Tabelës së Përfitimeve', shkaktuar nga një Aksident që ndodh brenda periudhës së sigurimit ',
Sigurimi i 'Pjesshëm i Shpenzimeve Spitalore nga Aksidentet';

'Përfitimi i pagueshëm': Siguruesi do t'i paguajë Policëmbajtësit/Përfituesit përfitimin e pagueshëm në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

'Humbja e jetes: 'Përfitimi i Pagueshëm' do të jetë 'shuma e mbetur e huasë në datën e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit',

Sigurimi i 'Paaftësisë së Plotë të Përherhshme nga Aksidentet': 'Përfitimi i Pagueshëm' do të jetë 'shuma e mbetur e huasë në datën e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit',

Sigurimi i 'Paaftësisë së Pjesshme të Përherhshme nga Aksidentet': 'Përfitimi i Pagueshëm' do të jetë 'një përqindje e shumës së mbetur të huasë në përputhje me Tabelën e Përfitimeve',

Sigurimi i 'Pjesshëm i Shpenzimeve Spitalore nga Aksidentet': 'Përfitimi i Pagueshëm' do të jetë 'përfitim në rast shtrimi në spital sipas parashikimeve të policës.

Kërkesa për përfitim të pagueshëm dhe/ose pagesa përfitimesh të pagueshme do të zvogëlojnë për të njëjtën shumë shumën e pakthyer të huasë në momentin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

Mbrojtja e të dhënave personale

I siguruari është njohur me deklaratën e privatesisë të shoqërisë së sigurimeve dhe autorizon SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.A sh.a që të mbledhë dhe përpunojë të dhënat dhe informacionin personal i cili nevojitet për administrimin e kontratës së sigurimit, për dhënien e shërbimeve ndaj të siguarit dhe përfituesit përfshirë trajtimin e dëmit, për ofrimin e produkteve apo shërbimeve të reja, bazuar në ligjet përkatëse në fuqi (ligji nr. 9887, date 10.03.2008, "për mbrojtjen e të dhënave personale") si dhe transferimin e të dhënave personale tek të tretë për qëllime të sigurimit apo biznesi të cilët garantojnë gjithashtu mbrojtjen e të dhënave personale. Në rast, mbrojtja e të dhënave personale do të bëhet në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 9887, date 10.03.2008, "për mbrojtjen e të dhënave personale".

Nepermjet lidhjes të kontratës, i siguruari autorizon shoqërinë e sigurimit që për efekt dhe zbatim të kontratës të sigurimit të marrë dhe/ose të përpunojë të dhëna personale përfshirë ato sensitive nga palë të treta me qëllim përpunimin e tyre.

E drejta e informimit

- i siguruari ka të drejtën të informohet nga siguruesi mbi kushtet, procedurat dhe afatet e mbulimit dhe/ose përfitimit nga sigurimi, informim i cili fillon para nënshkrimit të kontratës dhe vazhdon gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës. Informimi merret nepermjet telefonit, e-mailit, faqes zyrtare në internet apo broshurave informative të perdoruara nga shoqëria.

- i siguruari dhe/ose policëmbajtësi janë informuar nga siguruesi përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit, duke marrë të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me të dhënat juridike të siguruesit, llojin përkatës të sigurimit, procedurat, afatet, metodat e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, rreziqet e mbuluara dhe të perjashtuara, metodat e llogaritjes, afatet dhe menyrat e pagesës së primit, metodën e llogaritjes së vlerës së kompesueshme dhe cdo informacion tjetër që ka lidhje me kontratën e sigurimit.

E drejta e të siguarit për tu ankuar

I siguruari apo persona të tjerë të interesuar, kanë të drejtë të paraqesin një ankesë pranë shoqërisë së sigurimit, në rast se cmojnë se shoqëria e sigurimit nuk u përmbahet kushteve të vendosura në kontratën e

sigurimit. Ankesa mund te paraqitet ne forme elektronike (e-mail) ose me shkrim ne adresen postare te shoqerise. Shoqëria e sigurimit do ti pergjigjet çdo ankesë të depozituar me shkrim apo në formë elektronike dhe do te jap çdo informacion të kërkuar që ka lidhje me kontratën e sigurimit, brenda 15 ditësh nga marrja e kerkeses/ankeses.

Procedurat e kërkesavë për dëmshpërblim / përfitim

Njoftimi i ngjarjes së sigurimit

Me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit Policëmbajtësi duhet të njoftojë Siguruesin në një afat kohor sa më të shkurtër, por jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e marrjes së njoftimit për ngjarjen, duke specifikuar rrethanat dhe pasojat.

Prova e dëmtimit/humbjes

Prova me shkrim e dëmtimit / humbjes duhet t'i jepet Siguruesit sa më shpejt të jetë e mundur, brenda 30 ditësh nga Njoftimi i Dëmtimit/Humbjes, së bashku me kopjet origjinale të të gjithë dokumentacionit përkatës.

Personi i Siguruar ose Policëmbajtësi ose Perfituesi me shpenzimet e tij, do të t'i dorëzojnë Siguruesit në formën e kërkuar prej tij ato certifikata, informacione dhe të dhëna që Siguruesi do të kërkojë.

Siguruesi do të ketë të drejtën por jo detyrimin që, me shpenzimet e tij, t'i kërkojë Personit të Siguruar të kryejë kontrolle mjekësore sa herë të jetë e nevojshme gjatë periudhës së trajtimit të një kërkesë për dëmshpërblim/përfitim.

Subrogimi

Pagesa e përfitimi do të jetë në varësi të kalimit tek SIGAL Life i të gjitha të drejtave të policëmbajtësit/përfituesit/të siguruarit ndaj çdo pale të tretë përgjegjëse për ngjarjen e sigurimit, dhe asnjë person ose autoritet nuk do të veprojë për të paragjykuar këto të drejta.

Çdo kërkuar pagese sipas kësaj police, me kërkesën e SIGAL Life, do të ndërmerren dhe do të lejojë të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për ushtrimin e të drejtave ndaj çdo pale të tretë në emër të të Siguarit para dhe/ose pas çdo pagese të kryer nga SIGAL Life.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin nga kjo kontratë, nëse nuk zgjidhen me mirëkuptim, do të zgjidhen në rrugë gjyqësore.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është gjykata kompetente për zgjidhjen në rrugë gjyqësore.

Për çdo gjë që nuk është parshikuar në dispozitat e kushteve të sigurimit do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil.

Taksat dhe tatimet

Taksat dhe tatimet nese do ekzistojne do te jene ne ngarkim te te Siguarit/Policembajtesit/Perfituesit.